

VENDIM
Nr. 373, datë 20.5.2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 335, DATË 6.6.2018,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR
REGJISTRIMIN, TË PROCEDURËS DHE KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË
PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 19, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 335, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas pikës 3.23, të pikës 3, të kreut I, shtohet pika 3.24, me këtë përmbajtje:

“3.24 “Përdorim i vogël” nënkupton përdorimin e një produkti për mbrojtjen e bimëve në Shqipëri, të caktuar në bimë ose produkte bimore, të cilat janë:

a) jo të kultivuara gjerësisht në Shqipëri; ose

b) të kultivuara gjerësisht për të përmbushur një nevojë të jashtëzakonshme për mbrojtjen e bimëve.”;

b) Pas shkronjës “ç”, të pikës 5.4, të kreut II, shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) zgjerimin për përdorimet e vogla, pas paraqitjes së të dhënave, sipas pikave 6 dhe 7, të kreut VI, të këtij vendimi.”;

c) Pas pikës 5, të kreut VI, shtohen pikat 6, 7, 8, 9 dhe 10, me këtë përmbajtje:

“6. Aplikanti ose mbajtësi i dokumentit të regjistrimit, institucionet zyrtare ose shkencore, të përfshira në aktivitetet bujqësore ose organizatat/shoqatat profesionale bujqësore ose përdoruesit profesionistë, mund të kërkojnë që regjistrimi i një PMB-je të regjistruar të shtrihet në përdorime të vogla, që nuk mbulohen nga ai regjistrim.

7. Regjistrimi zgjerohet në përdorime të vogla, me kusht që:

a) përdorimi i synuar është i vogël në natyrë;

b) zgjerimi është në interes të publikut;

c) dokumentacioni dhe informacioni për të mbështetur zgjerimin e përdorimit është dorëzuar nga personat ose nga organet e përmendura në pikën 6, të këtij kreu, veçanërisht, të dhënat mbi nivelin e mbetjeve dhe, kur është e nevojshme, për vlerësimin e riskut për operatorin, punonjësin dhe kalimtarin.

8. Kur miratohet një zgjerim për përdorim të vogël, ministria përgjegjëse për bujqësinë, nëse është e nevojshme, informon aplikantin ose mbajtësin e dokumentit për regjistrim dhe i kërkon atij të ndryshojë etiketimin, në përputhje me rrethanat.

Në rast se aplikanti ose mbajtësi i dokumentit për regjistrim refuzon ta bëjë këtë, ministria përgjegjëse për bujqësinë siguron informimin e përdoruesve nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të ministrisë, duke përfshirë edhe udhëzimet specifike për përdorim.

9. Publikimi zyrtar sipas pikës 8, të këtij vendimi ose aty ku është e aplikueshme, etiketa duhet të përmbajë një referencë për përgjegjësinë e personit që përdor PMB-në, lidhur me dështimet për efikasitetin ose fitotoksicitetin e PMB-së, për të cilin është dhënë përdorimi i vogël.

10. Zgjerimi i përdorimit të vogël shënohet veçmas në etiketë dhe i referohet më vete kufizimeve të përgjegjësisë për efikasitetin ose fitotoksicitetin e PMB-së.”;

ç) Pika 3, e kreut IX, shfuqizohet.

2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR

Albana Koçiu